

Zbulohen 2 anije italiane të mbytura

(01/10/07) Enrik Mehmeti

VLORE -Gjiri i Vlorës ka nxjerë në pah dy anije italiane, të cilat janë mbytur në Luftën e Parë Botërore. Drejtori i Departamentit të Arkeologjisë Nënujore dhe Detare të Institutit Kombëtar të Arkeologjisë në Tiranë, Dr.Adrian Anastasi si dhe presidenti i Shoqërisë Ndërkombëtare të Zhytësve Profesionistë, (IANTD) kanë dhënë lajmin dje për këtë zbulim të rëndësishëm arkeologjik. Anijet “Re Umberto” dhe “Intrepido”, të mbytura që në vitin 1915, janë zbuluar diku ndërmjet Sazanit e Karaburunit, në thellësi rreth 50 metra. Anijet u bënë pre e minave të vëna nga një nëndetëse gjermane.

EKSPEDITA

Ekspedita për evidentimin e anijeve të mbytura ka nisur që prej 4 ditësh. Në dy ditët e fundit janë filmuar dhe fotografuar pjesët e të dyja anijeve të mbytura, ndërsa ekspedita do të përfundojë pas tri ditësh. Sipas Genci Kapllanit, i cili është njëri prej përfaqësuesve të Shoqatës së Zhytësve “Ekspedita Blu” dhe që kryen mbështetjen logjistike, u shpreh se “Gjiri i Vlorës fsheh relike të shumta të anijeve italiane me një rëndësi të veçantë historike, të cilat janë fundosur gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore”. Ai shtoi se lokalizimi dhe identifikimi i tyre merr rëndësi shkencore për të dy vendet. Ndërsa Dr.Adrian Anastasi tha se zbulimi i këtyre veprave do të jetë një pasuri nënujore me vlera të mëdha për vet qytetin e Vlorës.

HISTORIA

Anija “Re Umberto” po transportonte trupa luftarake kur është mbytur. Në bazë të të dhënave historike, pjesa nga ishulli i Sazanit dhe deri në afërsi të Vlorës pranë Zvërnecit, ishte minuar me qëllim që forcat gjermane të mos hynin në gji. Forcat e ushtrisë italiane kishin lënë të hapur vetëm ngushticën mes Karaburunit dhe Sazanit. Ky informacion siç duket, kishte shkuar edhe tek gjermanët. Ata nisën në mënyrë të fshehtë nëndetësen UC 14 që nga Turqia. Kjo nëndetëse kishte bërë minimin e zonës me mina nënujore, të cilat ishin vendosur në ngushticën e lënë për të kaluar mjetet ujore italiane. Pre e minave ra anija “Re Umberto”, e cila si pasojë e goditjes me minën, rreth orës 10:00 të mëngjesit të datës 4 dhjetor të vitit 1915, është ndarë në dy pjesë. Po në këtë pozicion është gjetur dhe sot. Sipas ekipit arkeologjik, në të janë mbytur rreth 60 persona. Pas marrjes së sinjalit për mbytjen e anijes, nga Italia është nisur anija tjetër luftarake “Intrepido”, e cila ka takuar në të njëjtin minim dhe është mbytur rreth orës 17:00 të po asaj dite. Sipas arkeologëve, në këtë anije janë mbytur 5 marinarë. Më pas, nëndetësja gjermane është larguar, ku sipas dokumenteve historike, është mbytur pas rreth 3 vjetësh në Belgjikë si pasojë e një defekti të brendshëm.

ZBULIMI

Sipas ekipit që u mor me studimin, kanë qenë të dhënat e mbledhura në mënyrë të saktë si dhe studimi i anijeve me përpikëri, të cilat kanë sjellë dhe do të sjellin në dritë të dhëna shumë të sakta në lidhje me kohën kur ka ndodhur mbytja, shkaku, personat që janë mbytur në të, si dhe një sërë faktesh të reja. Në pamjet e marra prej operatorit italian, Massimiliano Cannussa, duken pjesët e anijeve të mbytura, ku në disa prej tyre dallohen dhe struktura, pjesëza dhe disa detaje të anijes. Anija “Re Umberto” është gjetur në thellësinë 50 metra, ndërsa anija tjetër “Intrepido”, në thellësinë 30 metra. Sipas Dr.Adrian Anastasit, vazhdimi i kërkimeve në këtë fushë do të bëjë të mundur krijimin e një harte mbi vendndodhjen e anijeve të mbytura përgjatë dy luftrave.

Dy vite më parë u zbulua “Regina Margaret”

Dy vite më parë, në afër si të të njëjtit vend u gjet dhe një tjetër anije italiane, e cila ishte mbytur në 16 dhjetor të vitit 1916. Forcat e Mbrotjtjes shqiptare dhe ato italiane, kryen homazhet për marinarët italianë të mbytur në ujërat shqiptare. Në këtë tragjedi, gjatë Luftës së Parë Botërore gjetën vdekjen pasi u mbyt anija në det, 674 marinarë italianë. Mes 674 marinarëve të mbytur tragjikisht në ujërat e territorit shqiptar, 18 prej tyre ishin oficerë marine. Dy vite më parë, në bordin e anijes që u nis për homazhe kishte familjarë të marinarëve italianë të mbytur, ndërmjet tyre Ugo Bozzo, nipi i komandantit të anijes “Regina Margaret”, të mbytur në vitin 1916. Ceremonia përkujtimore në kujtim të anijes së mbytur, vazhdoi në luftanijen italiane, e cila me të gjithë pjesëmarrësit në bord u nis drejt detit pikërisht ku 91 vjet më parë ishte mbytur luftanija italiane “Regina Margaret”, 1.5 km nga ishulli i Sazanit dhe 1.2 km nga gadishulli i Karaburunit. Në ceremoni ishte edhe ambasadori italian, Atilio Masimo Janucci.